



Me qëllim implementimin e qëllimeve dhe aktiviteteve të parashikuara me Programin për përkrahjen e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2018, Qyteti i Shkupit, shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për mbledhjen e kërkesave
për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018,
të destinuara për financimin e aktiviteteve programore të
inkubatorëve të biznesit dhe qendrave për zhvillimin e inovacioneve

Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018, nga nën programi G1 zëri 464 nën zëri 464990 – të destinuara për financimin e përbashkët të shpenzimeve për inkubatorët e biznesit dhe qendrave për zhvillimin e inovacioneve, do të realizohet në bazë të Programit për përkrahjen e zhvillimit ekonomik lokal për vitin 2018 dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë thirrje.

1. Lëndë e thirrjes publike është financimi i përbashkët i shpenzimeve të inkubatorëve të biznesit dhe qendrave për zhvillimin e inovacioneve, përkatësisht përkrahje financiare të projekteve për:

- Organizimi i trajnimeve
- Shërbime konsultuese

Për financimin e përbashkët të shpenzimeve për projektet e inkubatorëve të biznesit dhe qendrave për zhvillimin e inovacioneve, janë parashikuar mjete me vlerë të përgjithshme prej 700.000 denarë.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë të gjitha shoqatat dhe fondacionet të cilat janë regjistruar në përputhje me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 52/10) për qëllime të lidhura me politikat e përkrahjes dhe zhvillimit të sipërmarrjes, konkurrencës dhe inovacioneve të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

3. Kushtet e pjesëmarrjes – Çdo aplikues mund të marrë pjesë në thirrjen publike vetëm me një projekt.

Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Fletëparaqitje e plotësuar në mënyrë kompjuterike për përkrahje financiare.
- Formulari i plotësuar në mënyrë kompjuterike për propozim – projektin;
- Aktvendim për regjistrim dhe gjendjen vijuese nga Regjistri Qendrorë;
- Deklaratë se për aktivitetet e theksuara në projekt, deri tani nuk janë shfrytëzuar mjete nga ndonjë organ tjetër i administratës shtetërore ose nga burime tjera, që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të aktiviteteve të njëjta nga burime të ndryshme;
- Raport për mjetet e marra nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin e kaluar fiskal dhe mënyra e realizimit të tyre (nëse organizata ka qenë përfitues i mjeteve të ndara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2017)

Dokumentacioni i lartpërmendur i plotësuar plotësisht dorëzohet në origjinal ose kopje të vërtetuar tek noteri.

Formularët Fletëparaqitja dhe Projekti për paraqitje në thirrjen publike, parashtruesit mund t'i tërheqin në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

4. Krite të vlerësimit të projekteve:

Vlerësimi i projekteve do të bëhet në bazë të këtyre kriterëve:

KRITERE	PIKË MAKSIMALE
1. Struktura organizative dhe resurset	30
1.1 A ka shoqata ose fondacioni strukturë të mjaftueshme organizative dhe resurse njerëzore për realizimin e projektit (të punësuar, vullnetarë aktiv, persona të angazhuar me honorar)	10
1.2 Biografi profesionale e profesionistëve të cilët marrin pjesë në realizimin e projektit	10
1.3 A disponon shoqata dhe fondacioni me zyra dhe pajisje teknike për realizimin e projektit	10
2. Listë referuese e projekteve	20
2.1 Listë referuese ose dëshmi (shembull: kontratë e nënshkruar) për më së paku 2 projekte të realizuara në fushën për të cilën aplikohet	20
3. Kualiteti i projektit	50
3.1 Sa do të kontribuojë qëllimi i përgjithshëm i projektit në realizimin e prioriteteve të dhëna, sa është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate	10
3.2 A ka siguruar shoqata ose fondacioni përqindje të pjesëmarrjes vetjake në realizimin e projektit	10
3.3 Sigurim i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave tjera	10
3.4 A është i qartë dhe i realizueshëm plani për realizimin e projektit	10
3.5 A është real plani financiar i propozuar (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive pozita përputhet me çmimet e tregut)	10
Krite të pikë maksimale	100

Fletëparaqitjet për financimin e përbashkët dhe zgjedhjen e propozim projekteve më të volitshme i shqyrton Komisioni i formuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit.

Qyteti i Shkupit mban të drejtën për ndjekjen e realizimit të projekteve.

5. Periudha e realizimit të projekteve – viti 2018

6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e plotë është e nevojshme të dorëzohen në arkivin e Qytetit të Shkupit, bul. “Ilinden” nr. 82, nga ora 08:30 deri në orën 15:00 **me shënimin** “Thirrje publike për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018, të destinuara për financimin e aktiviteteve programore të inkubatorëve të biznesit dhe qendrave për zhvillimin e inovacioneve”.

Fletëparaqitjet dorëzohen në zarf të mbyllur dhe vulosur, pa shenja të subjektit i cili dorëzon fletëparaqitjen, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacion të paplotë ose ato që do të dorëzohen pas skadimit të afatit të përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen

Shoqatat civile ose fondacionet, pjesëmarrëse në thirrjen publike, do të njoftohen për rezultatet në afat prej 15 ditësh nga dita e sjelljes së Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018.

Pyetjet për sqarime plotësuese mund të parashtrohen me shkrim ose nëpërmjet rrugës elektronike deri te Sektori për zhvillim ekonomik lokal në adresën vijuese: danielak@skopje.gov.mk.

Kontakti: Sektori për zhvillim ekonomik lokal

Tel: (02) 3297-328.